



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Analizë teksti dhe përkthim në Gjuhën B

Ngarkesa në orë/kredite 40 orë, 4 kredite: (20 leksione, 20 seminare)

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs ka për qëllim përgatitjen e studentëve për të zhvilluar aftësi të avancuara në analizën e teksteve dhe përkthimin nga shqipja në greqisht. Studentët do të marrin njohuri mbi zhanret e ndryshme tekstuale dhe do të aftësohen për të përkthyer materiale nga fusha të ndryshme, duke ruajtur saktësinë dhe stilin e origjinalit. Gjithashtu, kursi synon t'i pajisë ata me teknika të përkthimit dhe rishikimit të përkthimeve, duke përdorur burime dhe mjete teknologjike të avancuara. Një tjetër qëllim është përshtatja kulturore dhe ndërlidhja gjuhësore në përkthim.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të kuptojnë strukturat dhe funksionet e zhanreve të ndryshme tekstuale.
2. Të analizojnë në mënyrë kritike tekstet në gjuhën burimore dhe të identifikojnë elementet kryesore që duhet të përkthehen me kujdes.
3. Të përdorin teknika të ndryshme për përkthimin e poezisë, teksteve akademike, juridike dhe letrare.
4. Të rishikojnë dhe redaktojnë përkthimet e tyre për të ruajtur saktësinë dhe koherencën.

Rezultatet e pritshme :

1. Lexojnë, analizojnë dhe përkthejnë tekste nga një sërë zhanresh duke përdorur teknika të avancuara të përkthimit.
2. Ruajnë stilin, tonin dhe figurat stilistike të autorit origjinal gjatë përkthimit nga shqipja në greqisht.
3. Përshtatin përkthimet e tyre për audienca të ndryshme, duke marrë parasysh elementet kulturore dhe gjuhësore.
4. Përdorin mjete teknologjike dhe burime gjuhësore për të përmirësuar përkthimet dhe për t'i analizuar ato në mënyrë kritike.